

STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE “REAL RENT” sh.p.k.

Në Tiranë më datë 21 Tetor 2024 (dymijë e njëzetëkater) ditën e Hene u mblohdh:

Z.Erion Aga ,Atesia Ismail,Memesia Servete,datelindja 29.06.1989 , lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit ID: I90629065J.

I lartpërmenduri është madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me vullnetin e tij të lirë e të plotë ka vendosur të krijoj shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin.

Neni 1

EMËRTIMI DHE QËNDRA E SHOQËRISË

EMËRTIMI : “REAL RENT” sh.p.k

SELIA : Rruga e Rinasit,Ambjent i hapur pranë Aeroportit Nene Tereza,Zone Kadastrale 3183,Nr.Pasurie 46/16,Tirane

Shoqeria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe në bazë të Ligjit Nr 9901 të datës 14.04.2008 “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”. Shoqeria do të gjëzojë të gjithë të drejtat si person juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në QKB.

Shoqeria e ka selinë e saj në Tiranë, me adresë: **Rruga e Rinasit,Ambjent i hapur pranë Aeroportit Nene Tereza,Zone Kadastrale 3183,Nr.Pasurie 46/16,Tirane .**

Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Neni 2

QËLLIMI I SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë të saj do të jetë:

Aktivitet ne fushen e qiradhenies se mjeteve motorike, makina, autovetura, etj. Aktivitet ne fushen e shit-blerjes se pasurive te luajteshme si automjete, autovetura,si te perdorura dhe te reja. Aktivitet ne fushen e shit-blerjes se pjeseve te kembimit per automjete, si te perdorura dhe te reja. Servis dhe sherbimi



riparimi. Aktivitete ne fushen e turizmit, transport mallrash dhe pasagjeresh.

Import Eksport .

Objekt të veprimtarisë së saj shoqëria do të ketë edhe kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik të lejuar nga legjislacioni shqiptar, që përputhet me objektin e veprimtarisë së saj dhe që kanë rëndësi për të ardhmen e shoqërisë.

**Neni 3
REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË**

“Shoqëria”, në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri tregtare krijohet me objektivin për të vazhduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqipëtar.

Në këtë rast Ortakët do ta përshtasin “Kontratën e Themelimit” dhe “Statutin e Shoqërisë”, si dhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqiptare.

“Shoqëria” gëzon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar në Q.K.B. “Shoqëria” mund të ketë pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme, në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqipëtar. Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

“Shoqëria” do të ketë vulën e saj të cilën do ta caktojë me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4
TË DREJTA DHE DETYRIME**

“Shoqëria” ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj. “Shoqëria” gëzon të drejtën që të bëjë importimin dhe eksportime të nevojshme për realizimin e qëllimeve të saj pa asnjë pengesë. Ajo gëzon të drejtën e caktimit të çmimeve dhe të produkteve të saj që do të disponojë për tregun e brendshëm dhe të jashtëm sipas rregullave të Legjislacionit në fuqi. “Shoqëria” ka të drejtën e vénies (rëndimit) në Hipotekë të pasurisë së saj sipas Legjislacionit në fuqi. Ortakët kanë të drejtë të eksportojnë fitimin jashtë shtetit në valutë, të eksportojë lëndë të parë, produkte dhe shërbime konform Legjislacionit Shqiptar.—



Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbjet deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin themeltar.—

NENI- 5 AFATI- VULA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar dhe fiton personalitetin e saj nga momenti i rregjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (ish-QKR) në Tiranë. Shoqëria ka vulën e saj me përbajtje "**REAL RENT**" sh.p.k.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë në shoqëri.

Kapitali i Shoqërisë, në tërësi zotërohet nga Ortaku **Z.ERION AGA** i cili ka formuar kapitalin fillestar të shoqërisë në vlerën prej **100,000 lekë -- (Njëqindmije)** lekë, me 1 kuotë. **Z. ERION AGA zotëron 1 kuotë me vlerë 100,000 ALL (Njëqindmije)** lekë ose 100% të kapitalit të shoqërisë. Te gjithë kuotat e kapitalit themeltar janë të nënshkrueshme dhe të shlyeshme krejtësisht. Çdo kuote i takon e drejta e një vote.

NENI -7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI -8

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht por pasi tua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që j'u ofrohen të trëteve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë që duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.



NENI- 9

Kapitali i shoqërisë do të përbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luajtëshme apo të paluajtëshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

NENI 10

Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me parë ndaj shoqërisë. Gjithashtu ai gjëzon të gjitha të drejtat e lindura para largimit të tij.

NENI 11 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

Asambleja e ortakëve.

Administratori i Përgjithshëm/ Përfaqësuesi ligjor

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

NENI 12 ASAMBLEJA

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimor. Ajo mblidhet sa herë e shohin të arsyeshme ortakët me një quorum prej (60% e votave), por domosdoshmërisht për të miratuar bilancin vjetor të shoqërisë. Asambleja i merr vendimet me 50%+ 1 të votave të përgjithshme.

NENI 13


Asambleja vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, shtimin ose pakësimin e kapitalit, për emërimin e organit administrativ, për drejtimet kryesore të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin apo rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

NENI 14 ORGANI –ADMINISTRATIV

Administrator i Përgjithshëm i shoqërisë “REAL RENT”sh.p.k. caktohet **Z.Genc Aga, datelindja 05.12.1971, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar nga karta e identitetit ID:H11205075P**, për një afat kohor 5 –vjeçar, nga data e regjistrimit të shoqërisë në Q.K.B .

Administrator i Përgjithshëm ka të drejtë të administrojë pasurinë e shoqërisë dhe të kryejë veprimet bankare që kanë të bëjnë me llogarinë dhe veprimtarinë e shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë kanë të drejta e detyrime të barabarta ndaj shoqërisë e ligjeve.



NENI 15

Administrator i Përgjithshëm ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët përmbrashjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 6 të këtij statuti.

Organ Administrativ (Administrator i Përgjithshëm) është kompetente për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njofuar ortakët me shkrim 15 ditë më parë;
- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta duke lidhur kontrata pune, qirajë e veprime të tjera juridike në funksion të shoqërisë;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të veçanta), ndarjen e fitimit, etj.
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- emëruar përfaqësues duke i deleguar të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij.

NENI 16

KUSHTET EKONOMIKE

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri, mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

NENI 17

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kritereve të caktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 18



Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisin vitin e parë në momentin e regjistrimit në organet tatemore, ndërsa vite të tjera në Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabël sipas ligjeve në fuqi. Bilancet periodike (mujore, tremujore e gjashtëmujore) miratohen e nënshkruhen nga Administratori i Përgjithshëm e më pas ratifikohen në asamblenë e rradhës. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja dhe nënshkruhen nga administratorja/ Përfaëqësuesja Ligjore.

NENI 19

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim ortakëve në përpjestim me kontributin e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likujduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës ligjore, sipas vendimeve të asamblesë.

NENI 20

Nga fitimet e realizuara gjatë vitit finaciar shoqëria pasi bën zbritjen e humbjeve të vitit të mëparshëm, lë mënjanë 5 % të fitimit me të cilin krijohet fondi rezervë i domosdoshëm derisa ky fond të arrije masën 10 % të kapitalit themeltar.

NENI 21 MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çëshjet që nuk parashikohen në to zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në R.SH. Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

NENI -22 DISPOZITA TË VEÇANTA

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të asamblesë për shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative
- pamundësi veprimi
- shpërndahet me vullnetin e ortakëve
- riorganizohet në një formë tjetër.

NENI 23

Bazuar edhe në nenet e sipërcituara të këtij statuti asambleja cakton një ose më shumë likujdatorë të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer gjithë veprimet e likujdimit të saj, duke likujduar në rradhë të parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepricës se kapitalit të shoqërisë me përfundimin e likujdimit, kjo i shpërndahet ortakëve, ndërsa në rastin e pamjaftueshmërisë së kapitalit ortakët janë të detyruar të derdhin kuotat e tyre deri në nivelin e kuotave të kapitalit themeltar.

NENI 24

Mosmarrëveshjet midis ortakëve zgjidhen me pajtim, në të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 25

SHNDËRRIMI, SHPËRNDARJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË

Shndërrimi i shoqërisë “**REAL RENT**” sh.p.k. në shoqëri të tipeve të tjera, kolektive ose në drejtim të thjeshtë, mund të bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve.

NENI 26

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarë do shkaku si:

- Humbja e kapitalit të shoqërisë
- Pamundësi veprimi
- Me vendim të asamblesë të ortakëve
- Në këto raste pronari i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likujdimit dhe cakton një ose më shumë likujdatore duke ju përcaktuar dhe detyrat.—
- Administratori i Përgjithshëm dhe likujdatori janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë, përderisa ajo tu dorëzohet personave përkatës fizike e juridike duke u likujduar në rradhë të parë detyrimet ndaj personave të tretë që ka shoqëria. Në rast se fondet disponibël, rezultojnë të pamjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë likujdatori mund t'i kërkojë ortakëve themelues të shoqërisë që të derdhin tërësisht kuotat që i takojnë atij.

NENI- 27

DISPOZITA TË –FUNDIT



Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në regjistrin tregtar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit Tiranë.

NENI - 28

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve që do të bëjë asambleja si dhe ligjeve të veçanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën është hartuar vetë statuti.

NENI- 29

Ky statut u përpilua në prani të ortakëve duke shprehur vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ai u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila për t'u depozituar në QKB dhe për t'u shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

O R TAKU

ERION AGA

ERION AGA
